

## AKT THEMELIMI

I

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “One Marketing Agency” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Z. Gledis Lushaj, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 08/09/1999, lindur në Durres, banues në Durres, Lagjja nr.17, Rruga Adria, Pallati Galaktik, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal: J90908064V

#### *Pjesa e përgjithshme*

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 02/12/2020 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

#### NENI 1

##### *Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “ONE MARKETING AGENCY” Sh.P.K. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 2

##### *Forma*

Shoqëria tregtare “One Marketing Agency” Sh.P.K, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 3

##### *Zyra Qëndrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “One Marketing Agency” Sh.P.K do të ketë zyrën e saj qendrore ne: Durres, Lagjja nr.4, Rruga Skenderbej, zone kadastrale nr. 8514, me nr. pasurie 4/33, Durres.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 4

##### *Objekti i veprimtarisë*

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Sherbim marketingu on-line

#### NENI 5

### ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31/Dhjetor/2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

### **NENI 6**

#### ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare "One Marketing Agency" Sh.P.K mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

### **NENI 7**

#### ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "One Marketing Agency" Sh.P.K dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

### **NENI 8**

#### ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "One Marketing Agency" Sh.P.K është 1.000 (nje mije) Leke, ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. GLEDIS LUSHAJ është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

### **NENI 9**

#### ***Organet e shoqërisë***

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

### **NENI 10**

#### ***Administratori***

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. GLEDIS LUSHAJ.

#### **NENI 11**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

*Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.*

#### **ORTAKËT THEMELUES**

**Z. Gledis Lushaj**

**DURRES 02/12/2020**

  
